

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"**  
**FAKULTETI JURIDIK**

**SYLLABUSI**

**Lënda: Sociologji e së drejtës**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Juridik</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Sociologji e së drejtës</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Zgjedhore</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>4</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Semestri dimëror, Prishtinë</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof.Dr. Beqir Sadikaj, Ass. Mexhit Shaqiri</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:beqir.sadikaj@uni-pr.edu">beqir.sadikaj@uni-pr.edu</a> <a href="mailto:mexhit.shaqiri@uni-pr.edu">mexhit.shaqiri@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<i>Sociologjia e së drejtës është një disiplinë e re në kuadër të sociologjisë dhe si e tillë paraqet një lëndë të re jo vetëm për Kosovën por edhe me gjerë. Interesimi për këtë lëndë ka ardhur duke u rritur vazhdimisht dhe tanimë kjo lëndë është bërë mjaftë atraktive në shumicën e fakulteteve evropiane dhe botërore. Ajo që e shquan Sociologjinë e së drejtës është mënyra së si kjo lëndë e sheh të drejtën dhe zhvillimin e saj në raport me zhvillimet e përgjithshme shoqërore duke u munduar që të shkoqisë anën sociale të normës juridike si dhe efektin e zbatimit të saj në momentin kur ajo vjen në kontakt me individin.</i>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<i>Qëllimi i lëndës së Sociologjisë së drejtës është që të njohë studentët me një aspekt tjetër të së drejtës nga ajo që ata mësojnë tradicionalisht, ky është aspekti social i së drejtës. Në shekujt e fundit Bota është përballë me ndryshime të mëdha shoqërore, këto ndryshime kanë reflektuar në shumë sfera të jetës, pjesë e këtyre ndryshimeve ka qenë edhe zhvillimi i të drejtës dhe konceptimin e saj në përgjithësi. Si rezultat në kohën moderne është paraqitur nevoja që të këtë më shumë interaktivitet në mes të normës juridike dhe jetës shoqërore në përgjithësi. Prandaj qëllimi i kursit është</i>

që të njohë studentët me zhvillimin e të drejtës nga aspekti social, përkatësisht me elementet sociale të së drejtës duke filluar nga civilizimi i lindjes së lashtë e deri në kohën moderne. Kursi trajton dhe promovon brendinë sociale të së drejtës duke kundërshtuar qasjen dogmatike dhe shterpe të normës juridike. Promovimi i kësaj qasje që ka në fokus të saj kushtëzimin social të normës juridike si dhe raportin e saj me realitetin shoqërorë siguron një harmonizim funksionale në mes të këtyre dy segmenteve, normës juridike dhe jetës shoqërore në anën tjetër. Këtu përfshihet natyrshëm edhe ana implementuese e të drejtës apo normës juridike, përkatësisht efektet e zbatimit të normës juridike në shoqëri që përbën një segment crucial në zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi dhe të normës juridike në veçanti.

**Rezultatet e pritura të nxënies:**

- Përvetësimi i njohurive bazë lidhur me Sociologjinë e së Drejtës dhe aspektet sociale të së drejtës;
- Aplikimi qasjes kritike dhe mendimit kritik mbi konceptet e ndryshme, duke përfshi edhe kuptimin dhe zbatimin e normës juridike;
- Përfundimi me sukses i punimeve seminarike dhe se paku një punimi hulumtuese lidhur me efektet e zbatimit të normës juridike tek kategoritë e veçanta të shoqërisë dhe grupet e marginalizuara.
- Demonstrimi i pavarësisë individuale në mënyrën e të menduarit, i artikuluar në paraqitjet me shkrim dhe me gojë.

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	30	45 / 15	
Ushtrime teorike/laboratorike	15	45 / 15	
Punë praktike			
Kontaktet me mësuesin/konsultimet	30	30 / 15	
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	15	45 / 15	
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	15	45 / 15	
Përgatitja përfundimtare për provim	15	15 / 2	

Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	60	30 / 4	
Projektet,prezantimet ,etj	15	45 / 15	
<b>Totali</b>			
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<i>Metodologjia e aplikuar gjatë ligjërimit të lëndës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në: Metodën interaktive, punimet me shkrim, projektet hulumtuese duke përfshi punën individuale dhe atë në grupe,prezantimet e ndryshme, debatet, etj.</i>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<i>Vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes dy kolekfiumeve të rregullta, punimeve të ndryshme dhe prezantimeve si dhe provimit final.</i>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	<i>Dr.sc Beqir Sadikaj "Sociologjia e se drejtës", Prishtinë 2010</i>		
<b>Literatura shtesë:</b>	<i>Fatmir Zanaj, "Sociologjia e se drejtes" Tirane,2010 Dushko Verban, "Sociologjia prava", Zagreb 2006 Tomisllav Čokrevski, "Sociologijata na Pravoto," Shkup: 1996. Anthony Giddens, "Sociologjia", Tiranë: 1997. Luan Omari, "Shteti i së Drejtës," Tiranë: 2002. Jean Carbonnier, "Sociologie juridique" Paris: 1978 Zhan Karbonje, "Pravna Sociologjia," Titograd: 1992. Žorž Gurvić, "Sociologjia prava," Podgorica: 1997. Jacek Wodz, "Socjologia dla Prawnikow i Politologu," Varshavë: 2000. Ž. Gurvić, "Problemi Sociologjia prava" Zagreb 1966</i>		
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>			
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>		
<b>Java e parë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Rëndësia dhe aktualiteti i Sociologjisë të së drejtës</li> <li>– Zanafilla e Sociologjisë të së drejtës</li> <li>– Vështirësitë rreth përcaktimit të pozitës të Sociologjisë të së drejtës në mes të shkencave juridike dhe Sociologjisë.</li> <li>– Përkufizimi i Sociologjisë të së drejtës – objekti i studimit</li> </ul>		
<b>Java e dytë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Raporti i Sociologjisë të së drejtës me shkencat tjera shoqërore.</li> </ul>		

	<ul style="list-style-type: none"> <li>– <i>Sociologjia e së drejtës dhe filozofia e së drejtës.</i></li> <li>– <i>Raporti në mes të Sociologjisë të së drejtës me Historinë e së drejtës dhe të drejtës e krahasuar.</i></li> </ul>
<b>Java e tretë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– <i>Sociologjia e së drejtës dhe teoria e Shtetit dhe së drejtës.</i></li> <li>– <i>Raporti i Sociologjisë të së drejtës me të drejtën dogmatike.</i></li> <li>– <i>Sociologjia e së drejtës dhe kriminologjia.</i></li> <li>– <i>Sociologjia e së drejtës dhe psikologjia e së drejtës.</i></li> <li>– <i>Sociologjia e së drejtës dhe ekonomia – dimensionimi ekonomik i së drejtës.</i></li> </ul>
<b>Java e katërt:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– <i>Raporti në mes të Sociologjisë të së drejtës dhe Sociologjisë së përgjithshme</i></li> <li>– <i>Raporti në mes të Sociologjisë të së drejtës me Sociologjinë politike</i></li> <li>– <i>Sociologjia e së drejtës dhe Sociologjia e religjionit</i></li> </ul>
<b>Java e pestë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– <i>Metodat e Sociologjisë së drejtës</i></li> <li>– <i>Rëndësia e metodave në hulumtimin e dukurive shoqërore</i></li> <li>– <i>Të vërejturit si metodë</i></li> <li>– <i>Metoda historike komperative</i></li> <li>– <i>Metoda monografike</i></li> <li>– <i>Metoda statistikore</i></li> </ul>
<b>Java e gjashtë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– <i>Eksperimenti në Sociologji</i></li> <li>– <i>Metoda dogmatike</i></li> <li>– <i>Analiza e përmbajtjes</i></li> </ul>
<b>Java e shtatë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– <i>Zanafilla historiko-teorike e së drejtës</i></li> <li>– <i>Idetë dhe pikëpamjet për të drejtën në civilizimin e Lindjes së lashtë</i></li> <li>– <i>Paraardhësit e Sociologjisë të së drejtës në Greqinë Antike</i></li> <li>– <i>Platoni dhe pikëpamjet e tij për të drejtën dhe ndikimi i saj në organizimin e jetës shoqërore.</i></li> <li>– <i>Aristoteli për organizimin shoqëror dhe të drejtën</i></li> <li>– <i>E drejta romake dhe jeta reale, varëshmëria në mes tyre</i></li> </ul>
<b>Java e tetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– <i>E drejta dhe drejtësia në kohën e mesme</i></li> <li>– <i>Pikëpamjet e Aurelie Augustinit</i></li> <li>– <i>Toma Akuini për të drejtën dhe ligjin</i></li> </ul>
<b>Java e nëntë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– <i>Paraardhësit e Sociologjisë së drejtës në kohën e re</i></li> <li>– <i>Tomas Hobsi</i></li> <li>– <i>Baruh De Spinoza</i></li> <li>– <i>Monteskie</i></li> </ul>
<b>Java e dhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– <i>Kontributi i mendimtarëve gjermanë për Sociologjinë e së drejtës</i></li> <li>– <i>Immanuel Konti prej imperativit kategorik të ligji dhe drejta</i></li> <li>– <i>Hegel për të drejtën dhe rëndësinë e saj në organizimin e jetës së përbashkët</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Një qasje ndryshe për të drejtën në shek.XIX</li> <li>– Fridrich Karl Von Savigny</li> <li>– Teoria e Marksit dhe Sociologjia e së drejtës</li> </ul>
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Themeluesit e Sociologjisë të së drejtës në shek.XX</li> <li>– Pikëpamjet e Emil Dirkeimit për Sociologjinë e së drejtës</li> <li>– Maks Weberi dhe Sociologjia e së drejtës</li> <li>– Eugen Erlich dhe kontributi i tij për themelimin e Sociologjisë të së drejtës</li> <li>– Pikëpamjet e Georges Gurvitch për të drejtën dhe ligjin</li> </ul>
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Themeluesit e Sociologjisë të së drejtës në Amerikë</li> <li>– Oliver Wendell Holms dhe kontributi i tij për studimin e ligjit dhe të drejtës në aspektin sociologjikë</li> <li>– Pikëpamjet e Kordozos për interpretimin kreativ dhe funksional të së drejtës.</li> <li>– Rosko Paund dhe pikëpamjet e tij për jurisprudencën sociologjike</li> </ul>
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Objekti i studimit të Sociologjisë të së drejtës</li> <li>– E drejta dhe të kuptuarit Sociologjik të saj</li> <li>– Origjina e të drejtës dhe rëndësia e saj</li> </ul>
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Sistemi i së drejtës dhe llojet e së drejtës</li> <li>– Sistemi i së drejtës</li> <li>– Llojet e së drejtës</li> <li>– Rëndësia e së drejtës në organizimin dhe funksionimin e jetës shoqërore</li> </ul>
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Shmangia dhe kontrolli shoqëror</li> <li>– Krijimi i së drejtës sipas praktikës gjyqësore – vendimeve të gjykatave</li> <li>– Pozita aktuale e Sociologjisë të së drejtës në Kosovë.</li> </ul>

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<p><i>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes prezantohen në çdo fillim viti shkollor nga ana e mësimeve, poashtu këtu përfshihen edhe kriteret për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve.</i></p> <p><i>Rregullat e mirësjelljes kërkojnë mbajtjen e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, respektimi i orarit, etj.</i></p> <p><i>Ndërsa kriteret vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve kërkojnë që studenti t'i përmbahet orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve, etj.</i></p>